1127/20
26.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1127/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "ErPOWER" SH.P.K–Viti, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "ELECTRA"SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE Të OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE " . me nr. të prokurimit: 62500-20-4731-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë, më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "ErPOWER" SH.P.K–Viti, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE Të OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE " . me nr. të prokurimit: 62500-20-4731-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë.

II. **VËRTETOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE Të OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE " . me nr. të prokurimit: 62500-20-4731-5-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "ErPOWER" SH.P.K–Viti, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik "ErPOWER" SH.P.K–Viti, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 22.12.2020 me nr. 1127/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE Të OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE" me nr. të prokurimit: 62500-20-4731-5-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 06.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e "ErPOWER" SH.P.K – ankues se AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bere shkelje të LPP ne nenet e cekura ne piken 7, duke mos vlerësuar drejtë kur ka konstatuar të shpallë fitues OE "ELECTRA" GRAQANICE

AK e ka marre per baze një deklaratë pa date me te cilën OE ka deklaruar se e ka pranuar SHKRESEN E AK-së per zgjatje te validitetit te ofertave dhe se nuk e ka vazhdua validietin edhe per 60 dite duke mos e respektuar kërkesën e AK-se Komuna e Malishevës. AK nuk e ka vlerësuar ofertën e përgjegjshme të ofruar nga ne si OE. Duke i pare shkeljet e LPP-se te Komunës se Malishevës ne kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-s që ankesën tonë ta e pranoj si të bazuar dhe këtë procedurë ta e kthej në rivlerësim në mënyrë që AK të ketë mundësi të i eliminoja shkeljet e bëra.

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues "ErPOWER" SH.P.K duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues pjesërisht qëndron sepse pas kerkese nga Ak-ja per vazhdimin e validitetit nga operatorret ekonomik pjesëmarrës ne ofert , Operatori ekonomik "ELECTRA" SH.P.K me daten 07.12.2020 ka dorëzuar Deklaratën:

ELECTRA

Nga : Electra SHPK – Magjistralja Prishtinë – Lipjan , Suhodoll , 10500 Graçaicë

Për : Departamenti I Prokurimit

Kuvendi Komunal Malishevë

DEKLARATË

Me anë të kësaj deklarate konfirmojmë pranimin per zgjatje të validitetit të oferatve për tenderin **NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE TË OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE , nr.i prokurimit 62500-20-4731-5-2-1 , nr I brendshëm I prokurimit 62500-20-107-521**

Me respekt ,

Valon Gashi

S.H.P.K. ELECTRA GRAÇANICË

Siç shihet nga Deklarata me larte OE pranon vazhdimin e validitetit te ofertës mirëpo nuk përcakton numrin e ditëve qe do ta vazhdoj validitetin e ofertës.

Eksperti shqyrtues mendon se ky është një gabim minor pasi qe AK me kërkesën e saj te datës 02.12.2020 kërkon nga Operatoret Ekonomik qe te bëjnë KONFIRMIMI për zgjatjen e validitetit te ofertues te cilën OE "ELECTRA" SH.P.K e ka bere sipas kërkesë si dhe vazhdimin e sigurimit te tenderit te cilën e ka bere ne Kompaninë e Sigurimit "ELSIG" me numër te Polices nr. 89388 data e lëshimit 03.12.2020 ne kohe zgjatej prej 90 dite kalendarike

Me poshtë po japin kërkesën AK-se për Zgjatjen e validitetit dhe te vazhdimit te sigurimit te ofertës.

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit

Të nderuar,

DATË	02.12.2020
REFERENC-Ë	
PËR/ZA/TO	Operatoret Ekonomik
NGA/OD/FROM	**Nuhi Shalaj** Zyrtar i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për zgjatje e validitetit të ofertave dhe sigurimit te tenderit në bazë te Kregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik

Ju njoftoj se për arsye objektive **NDERTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE TË OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE Nr identifikues 62500.20.107.521**. nuk është finalizuar.

Në mënyre që të vazhdohen procedurat e prokurimit kërkojm nga ana e juaj duke u bazuar në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Neni 31 Validiteti i Tenderit paragrafi 4 **qe te zgjatni validitetin e ofertave për një periudhe prej "60" dirësh.**

Ju duhet të bëni edhe vazhdimin e sigurimit të tenderit në vlerë prej 1,000.00€ edhe per 90 ditë.

Konfirmimin për zgjatje te validitetit te ofertave dhe vazhdimimin e sigurimit të tenderit duhet të i konfirmoni me se largu 07.12.2020 ne ora 14:00h **në E-Prokurim tek aktiviteti i prokurimit i cekur më lartë.**

Nëse zgjatja e validitetit të ofertës dhe vazhdimi i sigurimit të tenderit nuk konfirmohet brenda afatit kohor të lartë shënuar, oferta juaj do të refuzohet si e papërgjegjëshme.

PS:Kjo vlenë për të gjithë Operatorët Ekonomik.

Me Respekt!
Menaxheri i Prokurimit

Nuhi Shalaj

Siç shihet ne baze te kërkese është kërkuar zgjatja e validitetit te ofertës për një periudhe prej 60 ditësh dhe sipas kësaj kërkesës është kërkuar vetëm konfirmimi për zgjatjen e validitetit te ofertave. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa operatorit ekonomik ankues. "ErPOWER" SH.P.K të merret si pjesërisht e bazuar. Dhe rekomandon që të mbetet ne fuqi vendimi i AK-se B58- NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti kontraktues nuk ka përgjigje

Operatori ekonomik me datë 06.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "ErPOWER" SH.P.K, se AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bërë shkelje të LPP-së në nenet e cekura në pikën 7, duke mos vlerësuar drejtë kur ka konstatuar të shpallë fitues OE "ELECTRA" GRAQANICE. AK e ka marrë për bazë një deklaratë pa datë me të cilën OE ka deklaruar se e ka pranuar shkresën e AK-së për zgjatje të validitetit të ofertave dhe se nuk e ka vazhduar validitetin edhe për 60 ditë duke mos e respektuar kërkesën e AK-së. AK nuk e ka vlerësuar ofertën e përgjegjshme të ofruar nga ne si OE. Duke i parë shkeljet e LPP-së nga AK, kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-s që ankesën tonë ta pranoj si të bazuar dhe këtë procedurë ta e kthej në rivlerësim në mënyrë që AK të ketë mundësi të eliminoj shkeljet e bëra.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është pjesërisht i bazuar sepse pas kërkesës nga AK-ja për vazhdimin e validitetit nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, operatori ekonomik "ELECTRA" SH.P.K me datën 07.12.2020 ka dorëzuar deklaratën në të cilën ceket: me anë të kësaj deklarate konfirmojmë pranimin për zgjatje të validitetit të ofertave për tenderin ndërtimi i trafostacionit për kyqje të objekteve publike dy qendrat e banimit social dhe

dy çerdhet publike, nr. i prokurimit 62500-20-4731-5-2-1...", ku kjo deklaratë është e vulosur dhe nënshkruar nga Valon Gashi. Siç shihet nga deklarata e cekur si më lartë, OE pranon vazhdimin e validitetit të ofertës mirëpo nuk përcakton numrin e ditëve që do ta vazhdoj validitetin e ofertës. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsideron se ky është një gabim minor pasi që AK me kërkesën e saj të datës 02.12.2020 kërkon nga operatorët ekonomik që të bëjnë konfirmimin për zgjatjen e validitetit të ofertës, të cilën OE "ELECTRA" SH.P.K e ka bërë sipas kërkesës, si dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit të cilën e ka bërë në kompaninë e sigurimit "ELSIG" me numër të polices nr. 89388, data e lëshimit 03.12.2020 në kohë zgjatje prej 90 ditë kalendarike.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, pasi që OE i rekomanduar edhe pse nuk e ka cekur shprehimisht që e zgjat validitetin për 60 ditë, i njëjti ka policën e vazhdimit të sigurimit të tenderit të cilën e ka bërë në kompaninë e sigurimit "ELSIG" me numër të polices nr. 89388, data e lëshimit 03.12.2020 në kohë zgjatje prej 90 ditë kalendarike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË";

1x1 OE "ErPOWER" SH.P.K–Viti;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.